



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXTETOR AFATMESËM 2026-2028 TË
BASHKISË SHKODËR”**

Konsultim publik : Njësia administrative: Ana e Malit.

Data : 09.09.2025

Ora : 15.00

Vendi: Shkolla “Idriz Hoxha”

Numri i pjesëmarrësve : Numri i pjesmarrësve 32, nga të cilat 3 gra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : Për draft-projekt planin buxhetor afatmesem 2026-2028 të Bashkisë Shkodër.

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ◆ Projekt-aktin e propozuar
- ◆ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ◆ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ◆ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ◆ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Zv.Kryetari i Bashkisë z. Rudin Beka hap takimin duke listuar disa nga punët e kryera dhe realizimin e kërkesave të dala nga dëgjesat e vtit të kaluar, si dhe duke prezantuar atë çfarë do të planifikohet edhe për vitin tjetër për investime në Njësinë administrative Ana e Malit. Ai shton se kuptojmë që nevojat dhe problematikat janë të mëdha, megjithatë jemi përpjekur që të kemi investime të shpërndara në cdo njësi. Investimi më i rëndësishëm ka qenë ai i asfaltimit të tre rrugeve Velinaj, Alimetaj dhe Vejukaj, kërkesë kjo e vazhdueshme e banorëve prej shumë vitesh.

Gjithashtu është realizuar hapja e kanalit të kufirit në një gjatësi prej 4 km si dhe hapja e kanaleve të dyta e të treta në një gjatësi prej 21 km me një impakt të madh në ruajtjen e tokave dhe në bujqësi. Janë kryer po ashtu punime të vazhdueshme për mirëmbajtjen dhe shtimin e ndriçimit publik si dhe mirëmbajtje e zakonshme e shkollave të zonës.

Kryetari i Këshillit Bashkiak z.Luli vijon takimin rrith projekt propozimeve në lidhje me buxhetin e vitit 2026 për Njësinë administrative Ana e Malit. Krahas buxhetimit që bën administrate, shton ai është e nevojshme për ne të marrim edhe sugjerimet nga ana e banorëve përsë i përket nevojave dhe problematikave që kanë nevojë për ndërhyrje në zonë. Kjo përhershë është e lidhur edhe me të ardhurat sepse në bazë të tyre planifikohen edhe investimet dhe ndërhyrjet. Kemi tashmë një vëmendje të shtuar si nga qeveria ashtu edhe bashkia sa i perket investimeve të ndryshme në zone. Ai sqaron se fokusi i takimit do të jetë tek funksionet dhe detyrat që ka Bashkia, mbetje, gjelbërim, mirëmbajtje shkollash, mirëmbajtje dhe asfaltimi rrugësh, ana sociale, turizmi apo të tjera punë për të cilat jemi të angazhuar. Flasim për taksat dhe tarifat kaq shpesh pikërisht sepse janë ato që krijojnë mundësinë që të bëjmë investime sipas atyre kërkeseve që ju i keni më prioritare për vitit 2026.

Z.Alimetaj,banor fshati Alimetaj :

- Falënderon Bashkinë për rrugën që është shtruar Alimetaj, por është e nevojshme që të kemi edhe sinjalistikë.
- Shkolla në Alimetaj, Elbaçe është pa ujë dhe ka nevojë për riparime dyersh.
- Një tjetër problematikë kemi me kuajt që dalin rrugës dhe është problematikë që nuk po gjen zgjidhje.

Zv. Kryetari Beka shprehet se jemi në dijeni të kësaj problematike, dhe është në proces shqyrtimi i kësaj situate.

Z.Isuf Hyseni, banor fshati Alimetaj

- Kemi nevojë për një furgon që lëviz nga Alimetaj në Shkodër.
- Fshatrat Obot dhe Alimetaj problem kryesor kanë që nuk furnizohen ujë të pijshëm. Nuk ka as rrjet dhe asnë investim në ujësjellës.
-

Kryetari i fashatit Obot:

- Kemi linjën e tensionit të lartë dhe po rrezikon jetë njerëzish sepse është shumë i amortizuar dhe ka nevojë të ndërrohet.
- Edhe në Obot kemi nevojë për kazana mbeturinash.

Z. Altin Salihu nga administrata shprehet se mjafton të na tregoni pikat ku jeni dakort për t'i vendosur koshat dhe ne jemi gati t'i vendosim direkt.

Kryetari i fashatit Velinaj Z.Riza Pllumbi:

- Rruga në Velinaj është bërë por ka mbetur gjysëm rruge sepse nuk ka një kanal kullues dhe është i nevojshëm të bëhet kjo ndërhyrje.
- Në fshatin Velinaj nuk kemi ndriçim brenda fshatit.
- Duhet të ndërhyhet në pastrimni e përroit në Velinaj dhe Vejukaj.
- Ura e Vejukajve është një tjetër nevoje emergjente.

Kryetari i fshatit Oblikë:

- Së paku deri tek ura duhet të thellohet përroi sepse është shumë i rrezikshëm kur ka rreshje shiu të medha.
- Duhet të kemi masa me gjoba për trajtimin e mbetjeve sepse sapo pastrohen koshat, ka banorë që hedhin mbeturinat jashtë tyre.
- Të merren masa për të larguar nga qendra dhe rruga koshat e mbeturinave në fshatin Oblikë.
- Edhe tek rruga e Goricës ka nevojë për spostim të koshave sepse aty është e rrezikshme prania e tyre.
- Ndriçimi në rrugën e Muriqanit është i nevojshëm.
- Sa i përket taksave kemi fatura të mëdha dritash dhe uji dhe janë shumë të larta.
- Në lidhje me pastrimin është punuar shumë mirë por përgjatë gjithë rrugës ka shumë mbeturina të hedhura përgjatë rrugës.
- Kur flasim për bujqësinë, kemi shumë nevoja për vaditje dhe pastrim.
- Duhet të ketë vëmendje edhe për magazinën e produkteve.

Z. Altın Salihu nga administrata shprehet se brenda javës do vijmë dhe do verifikojmë mundësinë për të spostuar këto kosha. Do mbesim në komunikim edhe me administratorin që të kemi dakordësi për vendin se ku mund të vendosim koshat dhe jemi gati për të ndërhyrë. Ai shton se për disa nga problematikat lidhur me rrugët, ka të bëjë edhe ARSH dhe jemi në komunikim për të vendosur.

Z. Bekim Mema, drejtor i përgjithshëm i Zhvillimit të Qëndrueshëm ekonomik shton se kemi një mundësi shumë të mirë nga AZHBR dhe Ministria e Bujqësisë për të investuar në lidhje me krijimit e magazinave me fonde që mbështesin ndërtimin e këtyre magazinave nga privati. Në lidhje me transportin, jemi koshient që ka problem dhe kjo është një nevojë e madhe për këtë shërbim. Si drejtori jemi të hapur për këtë proces dhe pse jo mund të subvencionohet edhe nga Bashkia sepse biznesi privat nuk ia del me të ardhurat që gjenerohen.

Banor, fshati Oblikë:

- Kemi vetëm një autobus në të gjithë qytetin dhe është e nevojshme të respektohet orari. Mund të digitalizohet dhe të ketë një kontroll me të mirë të lëvizjes së tyre.
- Ka 10 – 15 vite që kemi problemin me tregun e shumicës. Kemi nevoje që të kete një investim në këtë treg për mbulesë të tij.
- Kemi shumë kodra në zonën tonë rreziku i zjarreve është perhere permanent dhe duhet të kemi hapje te rrugëve në kodrat e Anës së Malit që të kemi mundësi për të ndërhyrë në këto zona kur ka zjarre.

- Më e rëndësishmja për ne është legalizimi dhe dhënia e certifikatave të pronësisë së tokave.

Z.Osman Vataksi, banor fshati Oblikë:

- A do ishte e mundur që të ketë një bashkim të shkollave sepse kanë mbetur nga 4 -5 nxënës në shkolla dhe duhet menaxhim më i mirë i kësaj situate, sepse janë shpenzime të tepërtë përmirimbajtjen këtyre shkollave.
- Pastrimi i rrugës Doganë – Shkodër, është emergjent pastrimi i saj përgjatë gjithë rrugës.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, **Z.Oltion Luli**, Kryetar i Këshillit bashkiak myll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

SEKRETARE

Zbardhi proces verbalin:

Bekim Mema



Irma Sulishti



Sabina Danaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK


LISTË PREZENCË

(Njësia Administrative Ana e Malit)

KONSULTIM PUBLIK: "Për Miratimin e Projektbuxhetit 2026 dhe Programit Buxhetor afatimesëm 2026-2028, të Bashkisë Shkodër"

Datë: 09.09.2025

NR.	EMRI MBiemri	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1	Osmom Vofshin	Obiliq Sipërm. Obiliq Sipërm	068 22 63 94	osmproekt@gmail.com	
2	Sokkeli Peroni	Obiliq	068 22 63 94		
3	Felber Hoxha	Munizioni	069 47 18869		
4	Marton Cakaj	Obiliq	067 26 94 095		
5	Hoxha Tërnja	Munizioni	069 24 61 325		
	Schovlet Lutx	Dronkuss	069 61 02 534	Hno Malit	
	Krodi Tefci	Dritik			
	Petriq Sulej	Marton D642B5529			

NR.	EMRI/MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
9	Tareq/waq Setay				
10	GONTIAN Dafa	B-Shtader	0671671808		
11	Jivhor Shafiq	B.S.M.D.C	069641339		
12	Ismet Hoxha		0672048431		
13	Skender Taçci	Murjan	069210201		
14	Hysni Hyseni	B.B.Gat.	0698613587		
15	Zeqir Hoxha	Vekine	0694167911		
16	Sofiane Hoxha	SH.TUFF	0672228264		
17	JURIDE SBEWI	MURJAN	0672808033		
18	Onisilda Breza	Murjan	0636279836		
19	Fotima Ristic	Udhagor	0688792003		
20	SH.KELLAH VISHI	E.GURIC	0689376422		
21	Forue Bondeli	B.Mukader			
22	Dostjela Ismajli	B.Shtader	064354001		
23	Amin Malsam	B.SHKODER	0684134849	Fax. 0684134849 E-mail. Malsam@electroshader.al	
24	Florri Bilek	B.Shtader	0696502609	Kolit biliqi75@gmail.com	
25	Hilmiqit Hoxha	B.Shtader	0682012323	Murjanet@me.com	
26	Eduart Taçi	MURJAN	0672543344		
27	Yozef Ideci	D.Shtader	06921658011	Yozef.Ideci@finsoft.com	
28	Rimane Faraj	Imfumgjer	0674674830		

NR.	EMRI/MBIEMRI	LAGJJA/FSHATTI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
29	Ali Lalyce	Dilek	0692 324 435		
30	Florjana Koliqi	N.SHP	0682042990	Alisafili i Vlobovec	Chay
31	Fatbardh Kusi	N.SHP	0676305001	Fatbardhku-Suhos.com	
32	Admir Tempa	D.B.NI	069319202	tempa203@gmail.com	H.F.T